



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr. 21, Datë 17.01.2025

"Për shqyrtimin e draftit të Dokumentit Analitik, të përgatitur nga secili prej Grupeve të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe nga Sekretariati Teknik, caktimin e relatorëve dhe vijimin e procedurave parlamentare"

Bazuar në nenet 24 dhe 32 - 41 të Rregullores së Kuvendit dhe në pikën VIII dhe X të vendimit nr. 50/2024, datë 30.05.2024 të Kuvendit të Shqipërisë "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", mbasi u njoh në seancë publike edhe me prezantimin e draftit të Dokumentit analitik, nga Ekspertët e GENL & ST, me propozim të Kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1.Të miratojë procesverbalin e zbardhur të mbledhjes paraardhëse, të zhvilluar më datë 17.12.2024.

2.Të nisë shqyrtimin në Komision të draftit të Dokumentit Analitik, hartuar dhe prezantuar në mbledhjen e KPP nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik, që përfshin tre shtyllat kryesore, Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit. (Sipas Aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi).

3.Të caktoj relatorët për realizimin e këtij procesi në Komisionin e Posaçëm Parlamentar, të cilët do të shqyrtojnë e relatojnë projektin për secilën nga shtyllat, përkatësisht për Shtyllën e I - Mirëqeverisja, Znj.Milva Ekonomi; për Shtyllën e II - Antikorrupsioni Znj.Etilda Gjonaj, ndërsa për Shtyllën e III - Sundimi i ligjit Z.Toni Gogu.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FATMIR XHAFAJ

Miratuar më 17.01.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR
MIRËQEVERISJEN, SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR SHQIPËRINË 2030 NË
BASHKIMIN EVROPIAN

Dokument pune i Komisionit

DOKUMENTI ANALITIK

Hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë
(Dokument i hapur për vlerësime, komente dhe propozime)

HYRJE

Rezoluta e Kuvendit “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”

Domosdoshmëria e kësaj reforme, shtyllat kryesore të saj, qëllimet, objektivat dhe rezultatet e pritshme;

Vendimi Nr.50/2024, i Kuvendit për miratimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar;

Parimet udhëheqëse për realizimin e kësaj reforme: Gjithëpërfshirja, Transparenca, Profesionalizmi dhe Standardet ndërkombëtare;

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmban një sintezë të të gjitha çështjeve që adreson dokumenti analitik për të 3 shtyllat e reformës: 1.Mirëqeverisja; 2.Antikorrupsioni dhe 3.Sundimi i Ligjit;

Dokumentat orientuese bazë për hartimin e kësaj analize do të jenë: Progres raportet e BE-së dhe dokumentat shtetërore, raporte të organizatave ndërkombëtare dhe organizatave vendase etj të publikuara kryesisht në vitet 2023 - 2024;

Metodologjia e ndjekur për kryerjen e kësaj analize si dhe angazhimet e kontributet e dhëna;

Kontributi dhe pritshmëritë e këtij Dokumenti Analitik si bazamenti për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit;

Shtylla I

MIRËQEVERISJA

HYRJJE

1.Konteksti – Vlerësimi

*Kushtetuta - Kuadri ligjor i brendshëm dhe ndërkombëtar që Shqipëria ka aderuar
Angazhime të Qeverisë shqiptare në organizmat ndërkombëtare
Progres raportet e BE-së, Raporti Screening Grup kapitujve të I “Themelorët” etj
Raportet e ndryshme ndërkombëtare si: GRECO, DASH, SIGMA, OGP etj
Raportet e organizatave lokale (kryesisht OShC dhe Biznesi)
Masat kyçe të udhërrëfyesve të miratuar: Reforma në Administratën Publike; Strategjitë
sektoriale, etj*

2.Arritjet dhe hapat pozitivë në këtë fushë (bazuar kryesisht në vlerësimet e bëra nga raportet ndërkombëtare dhe ato lokale)

3.Gjetjet kryesore dhe problematikat kyçe në këtë fushë (burimi kryesor: Raportet ndërkombëtare dhe kryesisht Raporti Screening i KE dhe Progres raportet për Shqipërinë në vitet 2023/2024).

4.Nevoja për adresime masash ligjore dhe institucionale.

I. Transparenca në Reformën e Administratës Publike

- Analiza e kuadrit ligjor dhe qasja ndaj përafrimit të Direktivave të BE-së;
- Gjetjet mbi zhvillimin dhe koordinimin ndërinstitutional të politikave prioritare;
- Funksionimi i politikave të transparencës në qeverisjen qendrore, vendore dhe institucionet e pavarura;
- Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në politikbërje;
- Zbatimi i vlerësimit të ndikimit rregullator për të monitoruar dhe përshtatur kornizën ligjore;
- Gjetjet mbi zbatimin e së drejtës për informim dhe e drejta për të përdorur të dhëna publike;

II. Efektshmëria dhe Integriteti i administratës publike

- Analizë mbi standardizimin e procedurave të rekrutimit në Administratën Publike dhe zbatimi i parimit të meritokracisë;
- Gjetjet dhe identifikimi i mekanizmave për zbatimin e sistemit të performancës në administratë, nëpërmjet sistemeve IT, etj;
- Analizë mbi sistemet e vlerësimit të riskut të integritetit në administratën publike dhe zbatimit të planeve të integritetit;

- Mekanizmat ligjorë dhe institucionale për mundësinë e krijimit të klasës së ekspertëve të fushave specifike në përshtatje edhe me fushat e kapitujve, si pjesë e procesit të integritetit evropian;

III. Llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor

- Analizë për mekanizmat ligjorë për llogaridhënien e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor;
- Gjetjet mbi mekanizmat institucionale për të rritur llogaridhënien e vendimmarrjes, të pushtetit qendror dhe vendor në mënyrë periodike;
- Zbatimi i mundësive ligjore për përfshirjen e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile për monitorimin e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor;
- Analizë për kuadrin ligjor sipas sektorëve i harmonizuar me Kodin e Procedurës Administrative;

IV. Ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara ndaj qytetarëve

- Analizë mbi funksionimin e digjitalizimit të shërbimeve publike me qytetarin në qendër, rritja e performancës dhe ulja e korrupsionit me synimin 100% shërbime online;
- E-government e ndërtuar sipas standardeve Evropiane (Kornizën Evropiane të Interoperabilitetit);
- Gjetjet mbi situatën ligjore dhe institucionale për qëndrueshmërinë kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve;

V. Efektiviteti dhe Transparenca në menaxhimin e financave publike

- Zbatimi i politikave të transparencës në menaxhimin e financave publike në institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore;
- Analizë mbi monitorimin e vazhdueshëm dhe efektiv të risqeve fiskale;
- Gjetjet dhe problematikat mbi zbatimin e efektivitetit të menaxhimit të financave publike dhe llogaridhënia;
- Analizë mbi transparencën dhe efektivitetin në menaxhimin e investimeve publike dhe financimeve të partnerëve tanë të zhvillimit;

PËRFUNDIME – GJETJE, VLERËSIME DHE REKOMANDIME për Shtyllën: MIRËQEVERISJA dhe NARRATIVA PUBLIKE (POLICY)
(Çështje kyçe për debat publik, trajtim e zgjidhje me Planin Kombëtar të Veprimit)

Shtylla II

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

HYRJE

1.Konteksti – Vlerësimi

Kushtetuta - Kuadri ligjor i brendshëm dhe ndërkombëtar që Shqipëria ka aderuar

Angazhime të Qeverisë shqiptare në organizmat ndërkombëtare

Strategjitë dhe dokumentat e politikave qeveritare dhe ndërsektoriale

Progres raportet e BE-së, raporti Screening Grup kapitujt e I “Themeloret”, etj

Raporte të ndryshme ndërkombëtare si: GRECO, Moneyval, DASH, OGP, Transparency International, OECD, etj

Raportet e organizatave lokale (kryesisht OShC dhe Biznesi)

Masat kyçe të udhërrëfyesve të miratuar: Shteti i së drejtës dhe Reforma në administratën publike; Raporti 2024 i BE-së “Shteti i së drejtës” etj

2.Arritjet dhe hapat pozitivë në këtë fushë (bazuar kryesisht në vlerësimet e bëra nga raportet ndërkombëtare dhe ato vendore).

3.Gjetjet kryesore dhe problematikat kyçe në këtë fushë (Burimi kryesor: Raportet ndërkombëtare dhe kryesisht Raporti Screening i KE dhe Progres raportet për Shqipërinë në vitet 2023/2024).

4.Nevoja për adresime masash ligjore dhe institucionale.

I. Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit politik

1.1 Situata aktuale, gjetjet dhe politikat për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit për zyrtarët e lartë politikë, të zgjedhurit dhe partitë politike. Konkretisht fokusuar në:

- Konfliktin e interesave të zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve;
- Deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe aseteve të zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve;
- Financimin dhe transparencën e financave në fushata të partive politike;
- Sponsorizimet dhe donacionet për partitë politike;
- Mekanizmat për procesin e pastërtisë së figurës për të zgjedhurit dhe zyrtarët e lartë;
- Parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit transnacional të zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve;

1.2 Situata dhe nevojat për një ligjbërje të pastër nga interesat individuale dhe hapësirat e korrupsionit në ligj

- Problematikat, mekanizmat ligjorë dhe institucionalë aktualë për të parandaluar dhe kontrolluar hapësirat për korrupsion në ligj;
- Gjetjet dhe masat ligjore dhe institucionale për rregullimin e lobimit nga zyrtarët e lartë dhe ata të zgjedhur;

II. Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në sektorët me risk më të lartë korrupsioni në qeverisje qendrore dhe vendore

2.1 Situata aktuale, gjetjet, rekomandimet për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në administratën publike qendrore, dhe sektorët e qeverisjes qendrore me risk të lartë ndaj korrupsionit

- Analizë për gjetjet dhe politikat ligjore dhe institucionale për luftën ndaj korrupsionit dhe ndalimin e konfliktit të interesit për nivelin drejtues në administratë;
- Mekanizmat ekzistues për kontrollin e figurës të nivelit drejtues në administratë, integriteti dhe kohëzgjatja në pozicionet drejtuese;
- Analiza mbi situatën aktuale lidhur me politikat institucionale dhe ligjore për luftën kundër korrupsionit në sektorët me risk më të lartë korrupsioni: tatime, dogana, prona, shëndetësi, arsim;
- Analiza mbi situatën aktuale lidhur me politikat institucionale dhe ligjore për luftën kundër korrupsionit në prokurimet publike, konçesionet, investimet strategjike, leje, licenca, etj;

2.2 Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në administratën publike të pushtetit vendor dhe sektorët e qeverisjes vendore me risk më të lartë ndaj korrupsionit

- Masat ligjore dhe institucionale ekzistuese për luftën ndaj korrupsionit dhe ndalimin e konfliktit të interesit për nivelin drejtues në pushtetin vendor;
- Kontrolli i figurës, integriteti dhe kohëzgjatja në detyrë të nivelit drejtues;
- Funksionimi i planeve të integritetit për organet vendore dhe mekanizmat kontrollues të tyre;
- Analiza e situatës dhe problematika për luftën kundër korrupsionit në sektorët me risk më të lartë korrupsioni: taksa, shërbime, menaxhimi i pronave dhe aseteve publike, leje, licenca etj;

2.3 Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në funksionimin e tregut të lirë, konkurrencës në sektorin privat dhe institucionet rregullatore, mbikëqyrëse dhe menaxhuese

- Situata dhe zbatimi i masave institucionale dhe ligjore për funksionimin kontrollin dhe mbikëqyrjen e tregjeve (bankare, sigurimeve, kapitalit etj), konkurrencës së ndershme etj;
- Roli i inspektimeve tek subjektet tregtare dhe funksionimi i masave për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit etj;
- Problematikat në institucionet mbikëqyrëse dhe rregullatore të tregut (AKU, AKEP, AMF etj);
- Situata aktuale dhe gjetjet në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorin privat;

III. Funksionimi dhe efienca e institucioneve që luftojnë korrupsionin, konfliktin e interesit dhe abuzimin me financat publike

3.1 Funksionimi institucional dhe efektshmëria e institucioneve me përgjegjësi në luftën kundër korrupsionit dhe monitorimit të efektshmërisë së fondeve publike brenda qeverisjes qendrore/vendore si dhe institucioneve të pavarura

- Kontrolli i brendshëm financiar publik dhe mbikëqyrja e menaxhimit të fondeve publike dhe procedurave nga institucionet qendrore dhe vendore (si inspektimi financiar i MF-së, mekanizmat audituese dhe kontrolluese të brendshme, mekanizmat audituese për financimet nga programet e huaja dhe ato të BE-së, programet IPA etj);
- Kontrolli dhe mbikëqyrja e menaxhimit të fondeve publike dhe konfliktin e interesit nga institucionet e pavarura të përcaktuara nga kushtetuta dhe ligji;

3.2 Mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit antikorrupsion dhe hetimi administrativ antikorrupsion

- Gjetjet për hetimin administrativ të korrupsionit (Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, Drejtoria Antikorrupsion në tatime dhe dogana, etj);
- Situata aktuale e hetimit dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit;

IV. Parandalimi i flukseve të paligjshme financiare dhe pastrimit të parave

4.1 Parandalimi i flukseve të paligjshme financiare me ndërhyrje keqdashëse të vendeve të tjera në ekonomi veçanërisht në procedurat e infrastrukturës kritike

- Situata dhe zbatimi i politikave për parandalimin e flukseve financiare me influencë keqdashëse nga vende të tjera që çënojnë ekonominë e vendit dhe infrastrukturën kritike;
- Kuadri ligjor dhe institucional ekzistues për parandalimin e pjesëmarrjes në procedura prokurimesh publike, investime strategjike etj, nga subjekte me ndërhyrje keqdashëse të vendeve të tjera;

4.2 Zbatimi i masave ligjore dhe institucionale dhe efektshmëria për parandalimin e pastrimit të parave

- Zbatimi i kuadrit të masave për parandalimin e pastrimit të parave;
- Zbatimi i sistemit të regjistrimit të pronarit përfitues dhe masave të tjera për parandalimin e pastrimit të parave;
- Aspektet ligjore dhe institucionale për parandalimin e pastrimit të parave në nivel transnacional;

V. Ndërtimi i një shoqërie me integritet

5.1 Analizë mbi masat institucionale ekzistuese për nxitjen e denoncimeve të rasteve të korrupsionit dhe përfshirjen e aktorëve e shoqërisë civile, qytetarët, grupet e interesit, etj për monitorimin e menaxhimit të financave publike nga aktorët

- Situata dhe mekanizmat ligjorë ekzistues për identifikimin dhe raportimin e rasteve të korrupsionit nga qytetarët, bilbilfryrësve, aktorët e shoqërisë civile, grupet e interesit etj;
- Mekanizmat ekzistues për mbrojtjen dhe garancitë e denoncuesve antikorrupsion;
- Situata aktuale për politikën ekzistuese për nxitjen e grupeve të interesit, shoqërisë civile, etj për monitorimin e menaxhimit të financave publike;

5.2 Analiza për zbatimin e politikave për ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe veçanërisht të të rinjve për ndërtimin e një shoqërie me integritet:

- Mundësitë ligjore dhe institucionale për mbështetjen e aktorëve të shoqërisë civile, etj për ndërgjegjësimin e qytetarëve për ndërtimin e një shoqërie me integritet;
- Zbatimin e programeve dhe kurrikulave arsimore në institucionet arsimore për nxënësit dhe studentët lidhur me integritetin dhe luftën kundër korrupsionit;

PËRFUNDIME – GJETJE, VLERËSIME DHE REKOMANDIME për Shtyllën: PARANDALIMI DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT – NARRATIVA PUBLIKE (POLICY)

(Çështje kyçe për debat publik, trajtim e zgjidhje me Planin Kombëtar të Veprimit)

Shtylla III

SUNDIMI I LIGJIT

HYRJE

1.Konteksti – Vlerësimi

*Kushtetuta - Kuadri ligjor i brendshëm dhe ndërkombëtar që Shqipëria ka aderuar
Angazhime të Qeverisë shqiptare në organizmat ndërkombëtare
Progres raportet e BE-së, raporti Screening cluster 1, Raporti i BE-së “Shteti i së drejtës” 2024,
etj
Raporte të ndryshme ndërkombëtare si: Greco, DASH, OGP etj etj
Raportet e organizatave lokale (kryesisht OShC dhe Biznesi)
Masat kyçe të udhërrëfyesve të miratuar: Shteti i së drejtës dhe Reforma në administratën
publike; Udhërrëfyesi i Funksionimit të Institucioneve Demokratike etj*

2.Arritjet dhe hapat pozitivë në këtë fushë (bazuar kryesisht në vlerësimet e bëra nga raportet ndërkombëtare dhe ato vendore)

3.Gjetjet kryesore dhe problematikat kyçe në këtë fushë (burimi kryesor: Raportet ndërkombëtare dhe kryesisht Raporti Screening i KE dhe Progres raportet për Shqipërinë në vitet 2023/2024).

4.Nevoja për adresime masash ligjore dhe institucionale.

I.FUNKSIONET E KUVENDIT, ROLI MBIKËQYRËS DHE MONITORUES

1.1. Funksioni ligjvënës

- Analizë mbi rolin e Kuvendit në procesin ligjvënës në respektim të parimit të ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve;
- Gjetjet dhe problematikat të funksionit ligjvënës në drejtim të cilësisë dhe efijencës së Kuvendit;
- Kuadri ligjor i brendshëm i Kuvendit dhe nevojat për përafrimin me legjislacionin e Parlamentit evropian;
- Zbatimi i programeve të digjitalizimit të proceseve dhe shërbimeve të Kuvendit përmes E-legjislacion, përafrimi me procedurat e Parlamentit evropian, etj;
- Zbatimi i procesit të konsultimit publik nga Kuvendi, roli i Komisioneve parlamentare në këtë drejtim, përfshirja e grupeve të interesit, platforma e konsultimit të projektligjeve;

1.2. Roli mbikëqyrës, koordinues dhe monitorues i Kuvendit duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve.

- Efektiviteti i rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj pushtetit ekzekutiv përfshirë agjencitë ekzekutive dhe institucionet e varësisë si dhe institucionet e pavarura;
- Analizë në kuadrin monitorues, procedurat dhe standardet e përdorura të mbikëqyrjes parlamentare për performancën e veprimtarisë së Qeverisë dhe institucioneve të varësisë, agjencive ekzekutive dhe institucioneve të pavarura si dhe mbikëqyrjen periodike të zbatimit të rekomandimeve të tyre, duke përfshirë periodicitetin e seancave dëgjimore vizitat në institucione dhe të gjitha format e tjera të parashikuara në rregullore etj ;
- Mekanizmat për monitorimin e zbatimit të legjislacionit (*pas miratimit*) në ligjet e përafruara me *acquis communautaire* dhe aktet normative me fuqinë e ligjit;
- Gjetjet mbi funksionimin e koordinimit institucional;
- Analizë dhe gjetjet për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe kushtetuese si Avokati i Popullit, KMD, etj;

1.3. Efektiviteti, Transparenca dhe Llogaridhënia e vetë Kuvendit.

- Analizë për efektivitetin e Kuvendit duke përfshirë performancën e strukturave administrative dhe atyre politike në shërbim të kompetencave ligjvënëse, mbikëqyrëse, monitoruese dhe koordinuese të Kuvendit;
- Zbatimi i programeve dhe i standardeve të transparencës së veprimtarisë së Kuvendit në drejtim të aktorëve të shoqërisë civile, palëve të tjera të interesuara dhe publikut;
- Gjetjet mbi zbatimin e mekanizmave ekzistues të transparencës së menaxhimit të fondeve të Kuvendit, transparencës së fondeve dhe çdo mënyrë tjetër financimi të donatorëve dhe BE-së;
- Akses i shpejtë dhe transparenca në dokumentacionin parlamentar për publikun dhe palët e interesuara;
- Mekanizmat ndërveprues të Kuvendit me aktorët e shoqërisë civile, media dhe publikun jo vetëm për transparencën por edhe për llogaridhënien për veprimtarinë e organeve të Kuvendit dhe Komisioneve parlamentare;
- Mekanizmat e transparencës për integritetin, backgroundin akademik dhe profesional, deklarimin e pasurisë, konfliktit të interesit etj, të të zgjedhurve (deputetët);

1.4. Zgjedhja e institucioneve të pavarura

- Analizë mbi proceset e zgjedhjes së drejtuesve të institucioneve të pavarura, duke përfshirë procesin meritokratik, transparent dhe dëgjuesat;
- Mekanizmat zhblokues në rastet e mungesave të dialogut politik të zgjedhjes së drejtuesve në institucionet e pavarura etj;

II. MBROJTJA, RESPEKTIMI DHE MEKANIZMAT GARANTUES TË TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT

2.1. Garantimi i të drejtës së pronës (duke përfshirë të gjitha institucionet)

- Analizë mbi gjetjet e procesit të zbatimit të së drejtës së pronësisë - proceset kalimtare, kompesimi i pronës, shpronësimi i drejtë;
- Zbatimi i vendimeve gjyqësore të GJEDNJ në fushën e të drejtës së pronës;
- Gjetjet dhe problematikat në rastet e shpronësimit për interes publik;
- Situata aktuale lidhur me funksionimin strukturor dhe procedurave të brendshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës bazuar në masat për digjitalizimin (cilësia e të dhënave të regjistruara për të avancuar ndjeshëm ritmin e regjistrimit të parë të pasurive të paluajtshme;
- Zbatimi i ligjit për finalizimin e procesit kalimtar të pronësisë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe gjithëpërfshirëse;

2.2. E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale

- Analizë mbi funksionimin dhe efikasitetin e rolit vendimmarrës të Autoritetit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Zbatimi i të drejtës së privatësisë sipas KEDNJ-së dhe *acquis*;
- Zbatimi i të drejtës së informimit, qasja e shpejtë në informacion në përputhje me standardet e BE-së;

2.3. Procesi i rregullt ligjor

- Zbatimi i standardeve të procesit të rregullt ligjor gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit;
- Zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm;
- Analizë mbi funksionimin dhe profesionalizmin e përfaqësuesve të shtetit dhe institucioneve publike në proceset gjyqësore mbi standardet e procesit të rregullt sipas jurisprudencës së GJEDNJ;
- Trajnim vazhdueshëm i kandidatëve që ndjekin Akademinë e Sigurisë mbi standardet e procesit të rregullt sipas jurisprudencës së GJEDNJ;
- Funksionimi dhe rritja e efikasitetit të sistemit të ndihmës ligjore falas (ndihmës parësore dhe dytësore) si mjet për të garantuar aksesin në drejtësi duke përfshirë dhe përdorimin e teknologjive (app, etj);

2.4 Forcimi i institucioneve të pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të njeriut

- Analizë mbi funksionimin dhe nevojat e institucioneve kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (*si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, etj*)
- Mekanizmat mbështetës për organizatat e shoqërisë civile mbrojtëse të të drejtave të njeriut në tërësi e në veçanti, të të drejtave të fëmijëve, grave, grupeve vulnerabël, etj)

2.5 Edukimi ligjor

- Vlerësim kombëtar nevojash mbi situatën e edukimit ligjor të publikut të grup-moshave të ndryshme në Shqipëri – përfshirë dhe vlerësimin e Strategjisë Kombëtare të Edukimit Ligjor të Publikut 2019-2023 me synimin e hartimit të një plani veprimi të detajuar;
- Mekanizmat ekzistues për përfshirjen e edukimit ligjor në çdo nivel të arsimit parauniversitar dhe universitar – kurrikula e detyrueshme;
- Analizë për situatën aktuale dhe zbatimi i një fushate kombëtare të edukimit ligjor në median publike;
- Funkcionimi i shërbimeve ekzistuese që ofrojnë këshillim ligjor falas – ofrim i shërbimeve mobile në komunitet veçanërisht në zonat rurale nga Zyrat e Ndihmës Ligjore Falas– akses i drejtë si e drejtë themelore;
- Gjetjet mbi mundësitë e reja për aksesimin e shërbimeve të qeverisjes online për qytetarët që nuk kanë njohuri digjitale, nëpërmjet krijimit të Zyrave të Ndihmës/Help Desk, etj:

III. KONSOLIDIMI I REFORMËS NË DREJTËSI

Ky është një komponent shumë i rëndësishëm për Sundimin e Ligjit përmes të cilit do të synohet që të bëhet një analizë e arritjeve dhe problematikave që vërehen në procesin e zbatimit të reformës në drejtësi mbështetur në Vlerësimet, Gjetjet, Problematikat dhe Rekomandimet e dhëna në këtë fushë nga *Progres raportet e BE-së, Raporti Screening cluster 1 i Komisionit Evropian, si dhe Rule of Law Report 2024: Country Chapter for Albania – Korrik'24, Masat kyçe të udhërrëfyesve të miratuar: Shteti i së drejtës dhe Reforma në Administratën Publike; Udhërrëfyesi i Funksionimit të Institucioneve Demokratike etj*

Me mbështetjen e stafit të Kuvendit, pjesë e Sekretariatit Teknik, është përgatitur një draft – koncept i cili do të konsultohet paraprakisht para se të bëhet publik dhe dokument pune, me Grupin e Ekspertëve të Reformës, Nëngrupin e përfaqësuesve dhe ekspertëve të vetë institucioneve të drejtësisë të cilat do të kenë detyrën ta hartojnë këtë analizë, për pjesën që lidhet me to, si dhe të propozojnë masat ligjore dhe institucionale që ato vlerësojnë se do duhet të jenë pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit për fushën e tyre.

Pjesë e këtij procesi do të jetë dhe konsultimi me misionet e asistencës ndërkombëtare që monitorojnë, asistojnë e mbështesin sistemin tonë të drejtësisë, mbështetur në marrëveshjet përkatëse me shtetin shqiptar.

000

KONKLUZIONE

MBYLLJA

Aneksë:

- i) Burimet e dokumentave të dhënave;*
 - ii) Ekspertët e angazhuar dhe Konsulentët e jashtëm;*
 - iii) Organizatat lokale dhe ndërkombëtare të përfshira në këtë proces;*
- etj*